



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2021:218137

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05709783

P.nr. 461/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, në lëndën penale kundër të pandehurit V. P., për shkak të veprës penale “Ngacmimi seksual” nga neni 183 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.4815/20, të datës 20.09.2021, me propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me mbështetje psiko – sociale, pas përfundimit të seancës së mbyllur të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 13.05.2024, në të cilin ish-in të pranishëm prokurori i shtetit Menduhi Kastrati, e dëmtuara e mitura A.M. me përfaqësuesit e saj ligjor prindërit N. dhe M. M., i pandehuri dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. N. D., si dhe Dr. J. Z. ekspert në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, në vijim (IPFK), me datë 14.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 20.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

V. P., nga i ati V. dhe e ëma H., e gjinisë Gj., i lindur më ... në Gj., me vendbanim në Rr. “M. e V.”, fshati J., Komuna e Gj., me numër personal të identifikimit ... , ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 27.06.2020, në intervale të ndryshme kohore gjatë ditës nga rrjeti social instagram, i pandehuri V. P., e ka ngacmuar seksualisht të dëmtuarën e mitur ... vjeçe A.M, për qëllim seksuale dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit, në atë mënyrë që kishte hapur një faqe në instagram me emër ..., me emër dhe foto të miturës A.M dhe duke ju ofruar meshkujve seks, më pastaj i pandehuri e kishte kontaktuar në rrjetin e saj social instagram të miturën A.M dhe në cilësinë e gazetarit të prezantuar si V. P. i kishte thënë se dëshiron ti ndihmoj që ti ndërpriten ato publikime, pastaj i kishte kërkuar që të luaj një lojë “vërtetë dënim” nga kishte kërkuar së pari të dij ngjyrën e brekëve e pastaj edhe ti dërgoj foto intime në të kundërtën do ti publikoj bisedën si dhe foto të saj, me çka tek e dëmtuara ka shkaktuar emocion, frikë edhe pasiguri.

- me këtë ka kryer veprën penale “Ngacmimi seksual” nga neni 183 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të dispozitës ligjore si më lartë dhe neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 56 par. 1 nën. par. 1.14, 69, 70, 83, 84 dhe 86 të KPRK-së, si dhe të neneve 332, 364, 365, 367, 449 dhe 515 të KPP-së të pandehurin e:

G J Y K O N ME DËNIM ME KUSHT

I. Ashtu që i vërteton Dënimin me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

II. URDHËROHET i pandehuri të përmbush detyrimin “Të mos qaset në internet dhe të kontaktojë me persona tjerë për sjellje të tilla apo të ngjashme”.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale – për ekspertizë psikiatrike të paguaj shumën prej treqind (300) Euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej njëzet (20) Euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit poashtu shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. E dëmtuara e mitur A.M me përfaqësuesit e saj ligjor prindërit N. dhe M. M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

Po ashtu, gjykata në bazë të nenit 515 të KPPRK-së lidhur me nenet 83, 84, 86 par. 1 nën.par.1.1, 1.3 dhe par. 4 të KPRK-së, të pandehurit:

I SHQIPTON MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUSHËM PSIKIATRIK NË LIRI

Masa e shqiptuar do të ekzekutohet nga personeli mjekësor i Qendrës së Shëndetit Mendor në P., sipas kohës së termineve dhe rekomandimeve të ekspertëve të psikiatrisë dhe do të fillojë të zbatohet menjëherë pas pranimi të vendimit.

Institucioni i Kujdesit Shëndetësor - Qendra e Shëndeti Mendor në P., detyrohet që kësaj gjykate t’i dërgojë raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit për të pandehurin K. R., së paku njëherë në gjashtë (6) muaj dhe të njoftojë gjykatën për çdo vështirësi në trajtim.

DETYROHET i pandehuri që të paraqitet në Qendrën e Shëndetit Mendor në P., që t’i nënshtrohet masës së shqiptuar, sipas rregullave të caktuara nga mjeku përkatës - psikiatri.

Në rast se i pandehuri pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet masës së shqiptuar sipas këtij aktvendimi ose arbitrarisht e braktisë trajtimin, gjykata mund të shqiptojë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Në bazë të nenit 86 par. 4 të KPRK-ës, trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri nuk duhet të kaloj periudhën kohore prej tre (3) viteve dhe do të pushojë vetëm nëse pas kalimit të këtij gjykata nuk ka marr ndonjë vendim tjetër.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.4815/20, të datës 20.09.2021, kundër të pandehurit V. P., për shkak të veprës penale “Ngacmimi seksual” nga neni 183 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata në kuptim të nenit 280 të KPPRK-së ka caktuar kohën për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, ashtu që pas hapjes së seancës, shpalljes së çështjes për gjykim, konstatimit të prezencës së palëve, udhëzimit për të drejtat dhe detyrimet e tyre, fillimisht ka ftuar ekspertin e IPFK-së Dr. J. Z. për të dhënë sqarime lidhur me ekspertizën psikiatrike të përpiluar nga grupi i ekspertëve të IPFK-së për të pandehurin V. P. për të konstatuar nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në shkallë esenciale apo nëse i njëjti është i aftë për të përballur gjykimin.

Eksperti i IPFK-së Dr. J. Z. në fillim të seancës së shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi në mendimin e dhënë me shkrim në lidhje me gjendjen e shëndetit mendor të pandehurit V. P. i datës 09.10.2023, i njëjti mund të merr pjesë në seancë gjyqësore, mund të konsultohet me mbrojtësin e tij, mirëpo për shkak të impaktit apo ndikimit që ka pasur në sferën emocionale tek i njëjti pasi që ka kuptuar seriozitetin e veprimeve të tij, për shkak të kësaj gjendje i njëjti ka vështirësi në përballjen e gjykimit dhe deklaratat e tij mund të jenë me defekte apo të shtrembëruara.

Prokurori i shtetit pas deklarimit të ekspertit të IPFK-së lidhur me gjendjen e shëndetit mendor të pandehurit V. P. ka deklaruar se në pikëpamje formalo juridike, aktakuza e ngritur ndaj të pandehurit plotësohet së bashku me propozimin për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me mbështetje psiko sociale, në drejtim të rritjes së shkathtësive ndër personalë, përfshirë edhe sferën e tij intime.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas deklarimit të ekspertit nga lëmi e Psikiatrisë Dr. J. Z. dhe mendimit të dhënë nga grupi i ekspertëve të IPFK-së, si dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurit në kuptim të nenit 321 par. 1 të KPP-së, i ka ofruar mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në fillim të shqyrtimit gjyqësor në prezencë të avokatit të tij mbrojtës ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjashme, të dëmtuarës së mitur dhe prindërve të saj prezent në sallën e gjykimit u ka kërkuar falje, ndërsa nga gjykata ka kërkuar që t'i shqiptoj një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë

shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj pasi çmoi dhe vlerësoi se kërkesat e parapara me dispozitat ligjore të nenit 242 par. 2 të KPP-së janë përmbushur, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ngase pranimi i fajësisë është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe dispozitat ligjore të KPP-së, propozoi që gjykata të njëjtin ta shpall fajtor dhe dënoj sipas ligjit, krahas sanksionit penal t'i shqiptoj Masën e Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik me mbështetje psiko sociale, në drejtim të rritjes së shkathtësive ndër personalë, përfshirë edhe sferën intime të tij, ndërsa me rastin e shqiptimit të llojit të sanksionit penal ka rekomanduar që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, moshën e tij relativisht të re në kohën e kryerjes së veprës penale, shprehjen e keqardhjes, si dhe rrethanat tjera lehtësuese dhe rënduese.

Përfaqësuesi ligjor i të miturës A.M babai i saj N. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, nga gjykata ka kërkuar që të njëjtin ta shpall fajtor dhe dënoj sipas ligjit, po ashtu për dëmin e shkaktuar si rezultat i veprës penale të kryer nga i pandehuri ka kërkuar kompensim dëmi moral, fjalën e të cilit e ka mbështetur edhe vet e dëmtuara e mitur A.M.

Mbrojtësi i të pandehurit V. P. av. N. D. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i pandehuri gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor sikurse edhe në fazat e mëhershme ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, aktakuza tani e ndryshuar me propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm është e pakundërshtueshme, ndërsa sa i përket llojit të sanksionit penal gjykata të merr parasysh faktin se kemi të bëjmë me person që ka ngecje në zhvillimin mendor dhe i cili ka nevojë për një përkujdesje sociale, të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion më të butë penal me të cilin mund të arrihet qëllimi i sanksionit penal.

I pandehuri V. P. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka se çfarë të shtojë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes së mendimit të palëve respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit si dhe përfaqësuesit ligjor të dëmtuarës të mitur A.M, rekomandimit të grupit të ekspertëve të IPFK-së, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërteton se në veprimet inkriminuese të pandehurit manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Ngacmimi seksual” nga neni 183 par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penal-juridik është përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi sanksionin penal si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që si rrethana lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e shprehur për veprimet e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, sjelljen korrekte të tij në gjykatë, kërkim falje palës së dëmtua dhe prindërve të saj, në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës relativisht të re, po ashtu si rrethanë lehtësuese mori parasysh faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale gjendja e tij për të kuptuar veprimet e tij ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj mbi bazën e arsyeve dhe rrethanave të sipër theksuara gjykata vlerësoi se dënimi me kusht si dënim alternativ i shqiptuar të pandehurit, është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij,

me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht i paraparë me nenin 47 të KPRK-së, i cili konsiston në risocializimin e të pandehurit me anë të pezullimit të dënimit, me të cilin dënim të pandehurit seriozisht i tërhiqet vërejtja dhe i bëhet me dije se nëse i njëjti kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit të përcaktuar si në pikën (I) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata do të revokojë dënimin me kusht dhe do të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht.

Gjykata me rastin e shqiptimit të masës së Trajtimit të Detyrueshëm Psikiatrik në Liri, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet nga neni 86 të KPRK-së, andaj duke marr parasysh të gjeturat nga ekipi i eksperteve të IPFK-së, rekomandimet që rezultojnë nga ekspertiza e Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, gatishmëria e të pandehurit për zbatimin e rregullt të masës, në konsultat psikiatrike dhe në përdorimin e rregullt të terapisë së përshkruar si dhe duke marr parasysh gjendjen e tanishme shëndetësore dhe nevojat për trajtim adekuat që kishin me ndikuar në shërim dhe rehabilitimin e të pandehurit, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi mundësinë e revokimit të dënimit me kusht është marrë në bazë të nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në bazë të nenit 462 par. 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 84 par.1 nën-par.1.2, nenit 86 të KPRK-së dhe neneve 248 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

P.nr.461/2021, Datë. 20.05.2024

Procesmbajtëse
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet kësaj Gjykate.